



## AKK PUBLIKON LITERATURË PROFESIONALE, LIGJORE E TEKNIKE



Duke marrë parasysh masat e marra nga Qeveria e Republikës së Kosovës me qëllim të parandalimit të përhapjes së sëmundjes COVID 19, për një kohë Agjencia Kadastrale e Kosovës ka punuar vetëm me staf esencial me prezencë fizike në zyrë, ndërsa falë zhvillimeve teknologjike u ka mundësuar zyrtarëve të saj dhe zyrtarëve të Zyrave Kadastrale Komunale punën nga distanca. Edhe pse në situatë të jashtëzakonshme, Agjencia Kadastrale e Kosovës si institucion përgjegjës për kadastër, gjeodezi, hartografi, gjeoinformacion dhe administrim të regjistrave pronësorë edhe në kohë pandemie ka ofruar shërbime dhe produkte për palë të ndryshme të interesit, pa ndërprerë. Po ashtu si rezultat i këtyre mundësive, pos ofrimit të shërbimeve dhe produkteve, ekspertët e AKK-së kanë kryer edhe punë kapitale të cilat kanë rezultuar me monitorimin e punëve të Zyrave Kadastrale Komunale, gjeodetëve të licencuar dhe kompanive të licencuara gjeodete, me trajtimin e lëndëve, kërkesave dhe ankesave të ndryshme nga palë të ndryshme, etj. Pos ofrimit të shërbimeve të sipër përmendura për qytetarë dhe institucione, AKK gjatë kësaj kohe ka përpiluar një varg dokumentesh profesionale, ligjore e teknike me qëllim të implementimit të ndryshimeve që rezultuan nga reformat e ndërmarra ligjore, respektivisht nga hyrja në fuqi e udhëzimeve të reja administrative nga fusha e kadastrës, regjistrimit të pronës dhe sistemit të adresave, respektivisht kornizën

e punës 2020/1, doracakun për rindërtimin e informacioneve kadastrale, doracakun për kadastrin e ndërtesave, udhëzuesin për regjistrimin e pronës në kadastër, etj. Përpilimin e këtyre dokumenteve e ka karakterizuar gjithëpërfshirja profesionale, pasi që pjesëmarrës në punëtori dhe kontribues me komente dhe sygjerime profesionale gjatë shikimeve publik të drafteve finale kanë qenë ekspertë nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, Zyrat Kadastrale Komunale, Shoqata e Gjeodetëve të Kosovës si dhe gjeodetë të licencuar, etj. Përmes këtyre dokumenteve është krijuar një standard i unifikuar i të gjitha procedurave dhe dokumentacioneve për matjen, krijimin dhe regjistrimin e njësive kadastrale, pastaj janë qartësuar procedurat teknike dhe përgjegjësitë për rindërtimin e informacioneve kadastrale si dhe janë



qartësuar procedurat për regjistrimin e pronës në kadastër e ngjashëm. Si rezultat i këtyre dokumenteve, AKK ia ka dalë që të mbulojë zbrazëtirat teknike e profesionale me të cilat në të kaluarën janë përballur profesionistët e fushës dhe qytetarët.

### DORACAKËT, PREZETIM I TYRE PËR EKSPERTË TË BANKËS BOTËRORE

Me qëllim të informimit të udhëheqësve dhe ekspertëve të projektit të Bankës Botërore për regjistrimin e patundshmërisë në kadastër dhe për infrastrukturën e informacioneve hapësinore me këto ndryshime dhe me përfitimet e qytetarëve nga to, Kryeshefi Ekzekutiv i AKK-së z. Avni Ahmeti i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij ka mbajtur një takim virtual me udhëheqësen e ekipit të Bankës Botërore, ekspertin për administrim të tokës z-njën Anchal Aanand dhe me bashkëpunëtorët e saj. Në takimin i cili kishte karakter teknik është diskutuar për kornizën e punës 2020/1, për doracakun për rindërtimin e informacioneve kadastrale, doracakun për kadastrin e ndërtesave, udhëzuesin për regjistrimin e pronës në kadastër, etj. Ekspertët e Bankës Botërore kanë vlerësuar avancimet, duke vlerësuar shumicën prej tyre në nivel me vendet e zhvilluara dhe kanë ofruar edhe përkrahjen e tyre për tejkalimin e sfidave me të cilat eventualisht mund të ballafaqohen ekspertët e AKK.

# Ministri Kuqi, takim me drejtorët e drejtorive dhe kryeshefat e agjencive

Pas emërimit në pozitën e Ministrit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit z. Blerim Kuqi ka ftuar në takim punë drejtorët e departamenteve dhe kryeshefat e agjencive të sistemuara në kuadër të ministrisë të cilën ai e drejton, përfshi edhe Kryeshefin Ekzekutiv të Agjencisë Kadastrale të Kosovës z. Avni Ahmeti. Qëllimi i takimit ishte njoftimi i ndërsjellë dhe prezantimi i planeve, aktiviteteve e sfidave të secilit departament e të secilës agjenci, nevojat më urgjente që kërkojnë veprim të menjëhershëm e ngjashëm. Në takim z. Kuqi ofroi bashkëpunimin e rezervë dhe përkrahjen përmes një komunikimi të shpeshë qoftë me vetë Ministrin qoftë me ekspertët e Ministrisë

dhe stafin e kabinetit të Ministrit. Duke marrë parasysh që takimi ishte i pari i këtij lloji, në të drejtorët e departamenteve dhe kryeshefat e agjencive bënë një ekspozim të projekteve, sfidave, planeve dhe të arriturave, dhe njëzëri u arrit përfundimi që komunikimi në secilin nivel të vazhdojë

në baza të përditshme. Takimet e tilla pritet të mbahen edhe në të ardhmen, duke shpresuar se përkrahja e Ministrisë dhe Qeverisë do të ngriste edhe kualitetin e punëve që implementohen në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.



## AKK, takim me shoqatën e bankave

Në vazhden e aktiviteteve dhe përkrahjes që Agjencia Kadastrale e Kosovës në vazhdimësi po i jep procesit të legalizimit të objekteve pa leje, në një takim të përbashkët të mbajtur mes Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe Shoqatës së Bankave të Kosovës u diskutua edhe mundësia e thjeshtësimit të procedurave dhe shkurtimeve të kohës për legalizimin e objekteve që janë në prona të hipotekuara. Nga ana e AKK-së kjo çështje tashmë është trajtuar dhe për detaje tjera teknike e sqarime shtesë ligjore do jepen në takimet e radhës me përfaqësues ligjor të bankave dhe atyre të AKK-së. Kërkesë e institucioneve bankare ishte edhe mundësia e lehtësimit të procedurave për regjistrimin, modifikimin dhe fshirjen e hipotekave, zhvillim ky që tashmë është realizuar nga ana e AKK-së dhe pritet implementimi nga ana e bankave në sistemet e tyre në një afat sa më të shkurtër kohor.

Me krijimin e kësaj lidhjeje mes Regjistratit të drejtave pronësore dhe sistemeve bankare, procedura e regjistrimit, modifikimit dhe fshirjes së hipotekave do të thjeshtësohet shumë, do shkurtohet koha e azhurnimit dhe do ulet maksimalisht mundësia eventuale e gabimeve në regjistrimin e tyre. Në takim Agjencia Kadastrale e Kosovës u përfaqësua nga Kryeshefi Ekzekutiv z. Avni Ahmeti, u.d Drejtori i Drejtorisë për Kadastër z. Korab Ahmetaj, ekspertet për kadastër z-nja Drenushë Januzaj dhe z-nja Leonora Sylejmani dhe eksperti i lartë ligjor z. Nadir Shyqeriu, ndërsa shoqata e bankave u përfaqësua nga z. Petrit Balijsa, z. Ramë Bajraktari dhe z. Kreshnik Kosumi. Pas takimit palët u dakorduan që të vazhdohet bashkëpunimi mes dy institucioneve dhe takimet në të ardhmen të jenë edhe më të shpeshta.



### Informata mbi AKK

Agjencia Kadastrale e Kosovës (në vijim të tekstit AKK) është autoriteti qendror për mirëmbajtjen e bazës së të dhënave kadastrale, për mirëmbajtjen e regjistrave pronësorë, për hartografi dhe GIS, për sistemin e unifikuar të adresave, për infrastrukturën kombëtare të të dhënave hapësinore (në vijim të tekstit, IKIH) dhe për administrimin e Infrastrukturës së Teknologjisë së Informacioneve (TI) respektivisht qendrës së parë dhe të dytë të të dhënave.

KRYESHEF EKZEKUTIV  
Avni Ahmeti  
Avni.Ahmeti@rks-gov.net

DREJTORATI LIGJOR  
bashkim.shaqiri@rks-gov.net

DREJTORATI I FINANCVE  
DHE ADMINISTRATËS  
Fazile Hamiti  
Fazile.Hamiti@rks-gov.net

DREJTORATI I TEKNOLOGJISË SË  
INFORMACIONIT  
Afërdita Thaçi  
Afërdita.Thaçi@rks-gov.net

DREJTORATI I KADASTRËS  
Korab Ahmetaj  
Korab.Ahmetaj@rks-gov.net

QASJA E GRUAS NË PRONË  
Ibadete Rexhepi  
Ibadete.Rexhepi@rks-gov.net

QASJA NË DOKUMENTE PUBLIKE DHE  
INFORMATA TË PËRGJITHSHME  
akk@rks-gov.net

# Legalizimi i objekteve pa leje, aktivitete të ngjeshura në AKK



Nën organizimin e Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të USAID, Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit (Departamentit të Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit), Zyrave Kadastrale Komunale në Komunën e Prishtinës dhe përfaqësuesve të Drejtorisë për Urbanizëm në Komunën e Prishtinës me datë 12 qershor në AKK është mbajtur takim për procesin e legalizimit, respektivisht qartësimi i disa procedurave për regjistrimin e objekteve të legalizuara në kadastër. Takimi kryesisht ka qenë i natyrës profesionale e teknike, me theks të veçantë mbarëvajtja e deritanishme e procesit të legalizimit kryesisht në Komunën e Prishtinës. Përmes debateve interaktive dhe gjithëpërfshirëse ekspertët e AKK-së të prirë nga Kryeshefi Ekzekutiv z. Avni Ahmeti së bashku me ekspertët tjerë trajtuan rastet konkrete të cilat u ngritën nga zyrtarët e ZKK Prishtinë si trajtimi i shtëpive individuale me kërkesa për regjistrim me njësi pjesë e ndërtesës, kategorizimi në disa raste të veçanta për shtëpitë individuale, regjistrimi i hapësirave të përbashkëta etj. Takimet e tilla do të vazhdojnë edhe në të ardhmen varësisht prej sfidave me të cilat ballafaqohen institucionet përgjegjëse për legalizimin e objekteve pa leje. Përndryshe, ky takim erdhi si rezultat i disa takimeve e diskutimeve tjera mbi procesin e legalizimit. Një takim i tillë ishte mbajtur me datë 29 maj në ambientet e Komunës së Prishtinës mes Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë

Kadastrale të Kosovës z. Avni Ahmeti dhe Drejtorit të Drejtorisë për Urbanizëm në Komunën e Prishtinës z. Ardian Ollur, që si fokus kishte procesin e legalizimit të objekteve pa leje dhe paraqitjen e lejeve të ndërtimit dhe të dhënave të tjera nga urbanizmi në gjeoportalin shtetëror. Ndërsa, me kërkesë të Departamentit për Planifikim Hapësinor, Ndërtim dhe Banim (DHNB) në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Ambientit, me datë 4 maj po ashtu ishte mbajtur takimi virtual i Grupit Koordinues për Legalizim, respektivisht mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe Ambientit, Agjencisë Kadastrale të Kosovës, Komunës së Prishtinës dhe Programit të USAID për Qeverisje Ekonomike. Në takim ishte diskutuar rreth realizimeve të akorduara nga aktivitetet paraprake,

ndërsa përfaqësuesit e institucioneve kishin prezantuar aktivitetet konkrete të tyre në këtë drejtim. Agjencia Kadastrale e Kosovës në këtë takim ishte përfaqësuar nga Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë z. Avni Ahmeti i shoqëruar nga u.d Drejtori i Drejtorisë për Kadastër z. Korab Ahmetaj dhe zyrtari i Lartë Ligjor z. Nadir Shyqeriu.



# Investimet gjeohapësinore - reagim dhe rimëkëmbje e Kosovës ndaj COVID-19



**Aanchal Anand**

Me më shumë se tetë miliona raste të COVID-19 në mbi 200 shtete, pandemia e Koronavirusit ka bërë kërdi në jo vetëm sistemet shëndetësore, por në ekonominë e tëra. Efektet e ashpra të Koronavirusit të ri do ta godasin edhe ekonominë e Kosovës - ku BPV e shtetit tani pritet të tkurret me 4.5 për qind në vitin 2020, një përmbysje e parashikimeve para-pandemike të rritjes prej 4 për qind. Ndërsa investimet në kujdesin shëndetësor janë të dukshme, investimet gjeohapësinore, siç janë ato të planifikuara në Kosovë nën financimin e Bankës Botërore Projekti për kadastër të patundshmërisë dhe infrastrukturë gjeohapësinore (REGIP) - janë gjithashtu kritike, pasi ato mund të përkrahin sektorë të ndryshëm të ekonomisë, përfshirë kujdesin shëndetësor. Infrastruktura e pjekur e të dhënave hapësinore (SDI) është thelbësore sepse i bashkon dhe i analizon kohën dhe lokacionin, dy faktorë vendimtar në çdo reagim ndaj krizës, që është veçanërisht e rëndësishme kur jeta është në rrezik për shkak të një virusi respirator shumë ngjitës. Një sistem tipik, i pjekur SDI, inkorporon një gamë të qartë të faktorëve në analizën e tij, përfshirë qeverisjen e mirë dhe politikën, standarde të ndryshme, grumbuj të pasur të të dhënave gjeohapësinore, kapacitetin njerëzor dhe institucional, kohën dhe të tjera. Sidoqoftë, një SDI e thjeshtë, siç është një gjeoportali me të dhëna themelore për lokacionin, gjithashtu mund të jep përkrahje praktike për përpjekjet në reagim ndaj COVID dhe t'i hap rrugën infrastrukturës më të sofistikuar të informacionit në periudhën afatmesme dhe afatgjatë. Shumë shtete janë mbështetur në SDI në luftën e tyre kundër COVID. Republika e Koresë, një shembull kryesor, ka bërë punë të mirë në kufizimin e përhapjes së COVID duke shfrytëzuar të dhënat e saj gjeohapësinore,

të ngulitura brenda dhe jashtë sistemit të saj shëndetësor. Gjurmimi me GPS i telefonave dhe automjeteve, krahas regjistrave të të dhënave të thirrjeve dhe informatave të transaksioneve të kartelave të kreditit, ishte e dobishme në gjurmimin e kontakteve dhe këputjen e zinxhirit të ngjitjes. Për më tepër Koreja përfiton nga një infrastrukturë gjeo-hapësinore të gjerë dhe plotësisht të integruar. Ministria e Tokës, Infrastrukturës dhe Transportit (MTIT), Ministria e Shkencës dhe TIK (MSIT) dhe Qendra Koreane për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (KCDC) operojnë me një sistem të përkrahjes së hetimit epidemiologjik të diagnostikimeve COVID-19 duke përdorur teknologjinë e mençur të qytetit - "Smart City Data Hub" e cila u krijua bashkërisht nga MTIT dhe MSIT. Portali Kombëtar i Informacionit Hapësinor Korean është shtylla kryesore e infrastrukturës së informacionit të këtij sistemi dhe siguron se të dhënat ndahen në aso mënyre që e lehtëson gjurmimin e kontakteve në kohë reale, mundëson parashikimet se ku ka gjasa të krijohen vatrat, dhe kështu informon zbatimin e resurseve. Projekti REGIP i Kosovës, i cili është në pritje të ratifikimit parlamentar, planifikon përkrahjen e zhvillimit të SDI-së së re të Kosovës përgjatë linjave të ngjashme duke investuar në grumbujt e të dhënave rreth prioritetëve ekonomike për Kosovën, duke përmirësuar Gjeoportalin Shtetëror për ta sjellë atë në përputhje me standardet ndërkombëtare, duke siguruar ndërveprimin e portalit me grumbujt e të dhënave prioritare për ta mundësuar shkëmbimin e shpejtë të të dhënave dhe ruajtjen e privatësisë së të dhënave. Këto investime mund t'i përkrahin përpjekjet e reagimit ndaj COVID duke bërë të mundur parashikimin vatrave, duke mundësuar që përgjigjet e kujdesit shëndetësor dhe të rrjeteve të sigurisë sociale të arrijnë tek ata që kanë më së shumti nevojë. Në periudhën afatmesme, këto investime gjithashtu mund ta ndërtojnë reziliencën e Kosovës ndaj çdo vale të mëvonshme të COVID derisa vakcina të bëhet e disponueshme. Rezilienca më e lartë do të përkthehet në ndikime më të ulëta ekonomike. Për më tepër, bërja e

Gjeoportalit ndërvepruese me disa prej grumbujve ekzistues të të dhënave, si regjistri civil, regjistri i adresave dhe regjistri social, mund ta lehtësonte shpërndarjen më të shpejtë të ndihmës qeveritare për qytetarët e cenueshëm. Në periudhën afatmesme gjer afatgjatë, investimet gjeohapësinore të Projektit REGIP gjithashtu mund të shërbejnë si një levë e rëndësishme për rimëkëmbjen ekonomike. Studimet tregojnë se përfitimet e pritura të informacionit gjeohapësinor kanë tendencë të jenë afërsisht 3.2 herë më të mëdha sesa investimet fillestare. Përfitimet nxiten nga fakti se ndarja në kohë reale e grumbujve të të dhënave të ndryshme gjeohapësinore mund të sigurojë informatë të vlefshme, ta përmirësojë cilësinë dhe shpejtësinë e vendimmarrjes dhe t'i zvogëlojë kostot e dyfishta të grumbullimit të të dhënave nëpër agjenci të ndryshme qeveritare. Për shembull, disponueshmëria e të dhënave për pronësinë e tokës mund ta shpejtojë krijimin e një fabrike, dhe qasja në të dhëna për lartësinë mbidetare mund të sigurojë se objekti i ri ndërtohet në lokacione të sigurta, larg zonave ku ka tendencë të rrëshqitjes së dheut ose përmytjeve, gjë që mbron jetën dhe mbron mirëqenien ekonomike kundër katastrofave të ardhshme. Sektori privat mund të përfitojë edhe nga qasja në të dhëna të hapura ose të dhëna të hapura API që mund të ndihmojnë në uljen e kostos së shërbimeve ekzistuese ose nga lancimi i shërbimeve të reja pasi bizneset të fitojnë qasje në të dhëna për klientët, tregjet, zinxhirët e furnizimit, etj. Investimet gjeohapësinore paraqesin përfitime afatshkurtra dhe afatgjata në reagimin e Kosovës ndaj krizës COVID dhe planeve për rimëkëmbje ekonomike që do të pasojnë. Si partner i zhvillimit të Kosovës, ne në Bankën Botërore i mbetemi të përkushtuar lehtësimit të investimeve të rëndësishme në infrastrukturë dhe praktikave më të mira ndërkombëtare për ta përkrahur Kosovën gjatë krizës COVID me 14.6 miliona € në dispozicion sapotë ratifikohet projekti REGIP.

**(Autorja është eksperte e Bankës Botërore për administrim të tokës)**